

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin***Korrik, 2019***Në Tajlandë është mbajtur Kongresi 8 Botëror i Internacionales së Arsimit*

Ngjarje e madhe me vendime të rëndësishme për arsimin kudo në botë



Komisionet e emëruar nga Internacionalja Botërore e Arsimit për përgatitjen e Kongresit 8 zgjedhor kishin nisur me kohë përgatitjet dhe vazhdimisht kanë komunikuar me sindikatat anëtare për të marr ide e për të parë nga afër tekstet e Rezolutave të shumta që do të paraqiteshin në Kongres. Kontribut në gjithë këto angazhime ka dhënë edhe SBASHK-u duke dhënë mendime e duke dërguar amendamente për disa nga Rezolutat e parapara ...(faqe 5)

**Reagim i SBASHK-ut
lidhur me deklaratimet e
Ministrit Bytyqi për Ligjin
e viteve të 90-ta**



Punëtorët e arsimit dhe
opinionit e di se ...(faqe 8)

Intervistë me Alban Zenelin
nga Departamenti i
gazetarisë



Trajnimi për mediet dhe
rolin e tyre hap i qëlluar i
SBASHK-ut (faqe 3)

*Përshtypje të paharruara nga pushimet e organizuara prej
SBASHK-ut*



Momente që nuk harrohen kurrë

Anëtarësia e SBASHK-ut edhe këtë vit mbeti shumë e
kënaqur ...(faqe 9)

Lidhur me idenë e MASHT për mësimin tërëditor



SBASHK- Në kushtet aktuale në arsimin tonë nuk ka mësim tërëditor

Në vend që të analizohet gjendja me tekstet ...(faqe 9)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Krenaria për SBASHK-un



Puna, përkushtimi, qëndrimi i dinjitetshëm, mbajtja e fjalës së dhënë kanë bërë që punëtorët e arsimit, shkencës e kulturës të ndjehen mirë që e kanë sindikatën e tyre. Ata me krenari flasin për përballjet dhe për arritjet e shënuara gjatë viteve. Flasin me krenari edhe për qëndresën e unitetit gjatë kohëve plot sfida.

SBASHK-u kaloi edhe gjatë vitit të kaluar shkollor nëpër shumë sfida në përpjekjet për realizimin e kërkesave legjitime. Me mund e sakrificë erdhëm deri të finalizimi i Ligjit për vitet 90-ta duke i dalë borxhit kështu gjithë pishtarëve të dijes që me mund e sakrificë sublime mbrojtën arsimin shqip nëpër vitet e rënda të okupimit.

Me mund e shumë sakrificë e falë përkushtimit të njerëzve në qendër dhe unitetit të anëtarësisë arritëm bashkërisht edhe të

ndryshojmë koeficientet në Ligjin e pagave. Nuk lejuam që arsimit të ketë pozitive degraduese e nënçmuese në tabelorin e këtij ligji.

Me përpjekje e përkushtim arritëm të organizojmë edhe shumë trajnime kudo në komunat e Kosovës në përpjekje për të ndihmuar kolegët tanë që të arrijnë të kenë numrin e kërkuar të orëve të trajnimit me rastin e licencës së parë tani e me rastin e fillimit të gradimit në të ardhmen.

SBASHK-u fitoi shumë seanca gjyqësore në angazhimet për të siguruar të drejtën e garantuar me Kontratën e Arsimit të Kosovës . Me punë e shumë përkushtim kemi shënuar arritje të shumta dhe kemi krijuar një besim të lartë te anëtarësia. Është shtuar shumë numri i anëtarëve në SBASHK dhe kjo shton obligimet e të gjithë neve. Duhet të vazhdojmë me punë e angazhime. Duhet të vazhdojmë të ndjehemi krenar me SBASHK-un.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimit sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me Alban Zenelin nga Departamenti i gazetarisë



Trajnimi për mediet dhe rolin e tyre hap i qëlluar i SBASHK-ut

Alban Zeneli është njohës i shkëlqyer i gazetarisë. SBASHK-u ka një bashkëpunim të vazhdueshëm me të dhe vazhdimisht këshillohemi

me të lidhur me mënyrat sa më të mira të prezantimit para opinionit për sfidat, idetë dhe angazhimet tona. Ai me një grup trajnerësh, të cilët janë ekspertët më të mirë të kësaj fushe, kanë nisur me trajnimet për mësimdhënësit kudo në Kosovë pikërisht me “Edukimi Medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik”. Në këtë intervistë do të flasim për rëndësinë e këtij trajnimi dhe për lajmin se lënda për mediet do të jetë e pranishme në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë.

Arsimimi sot:

Çfarë është Edukimi për Media?

Albani:

Edukimi për media është një domosdoshmëri e kohës në të cilën po jetojmë. Ideja themelore e tij është që t'i mësojë sidomos të rinjtë se si t'i përdorin mjetet e komunikimit. Mësimi për të krijuar një gjykim kritik mbi përmbajtjen e medieve dhe për funksionin e tyre shoqëror është bërë e domosdoshme sidomos sot kur pluraliteti në media është në një shkallë të lartë. Më rritjen e numrin të mediave, sidomos atyre online, e veçanërisht rrjeteve sociale, është rritur nevoja që të rinjtë të kenë njohuri bazë për të iu shmangur dezinformimit, lajmeve të rreme e problemeve të tjera të cilat janë shfaqur.



Arsimimi sot:

Pse duhet të trajnohen mësimdhënësit për këtë fushë?

Albani:

Mësimdhënësit e të gjitha niveleve të shkollimit parauniversitar duhet të jenë të informuar për funksionet dhe keq-funksionet e medias, mundësitë e përdorimit për të mirë të medieve, dhe po ashtu mundësinë e përdorimit të tyre edhe për procesin mësimor. Së bashku me një grup të profesorëve të Departamentit të Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, kemi filluar një iniciativë të tillë që disa vite, me qëllim që fillimisht mësimdhënësit të jenë të përgatitur për Edukimin për Mediet e pastaj ato njohuri t'i bartin te nxënësit. Në kurrikulën e re bërthamë të miratuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, është bërë e mundur që kjo lëndë të propozohet si lëndë zgjedhore në arsimin parauniversitar, pra mësimdhënësit tashmë mund ta propozojnë si lëndë zgjedhore Edukimin për Media. Kjo është një gjë e mirë që ka ndodhur, por mendoj që kjo lëndë tashmë është bërë e domosdoshme dhe si e tillë duhet të përfshihet si lëndë obligative që nga shkollimi fillor i nxënësve në sistemin tonë publik të arsimit.

Arsimimi sot:

Si lindi ideja e certifikimit të këtij trajnimi?

Albani:

Bashkëpunimet e mia me Sindikatën e Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës kanë një histori disa vjeçare, që nga koha kur përmes një projekti të BE-së pata shkruar një plan të komunikimit në këtë sindikatë. Që nga ajo kohë, e pata shfaqë mundësinë që të bashkëpunojmë me SBASHK-un edhe për fushën e Edukimit për Media. Vitin e kaluar së bashku me disa profesorë të Departamentit të Gazetarisë, kemi aplikuar nëpërmjet sindikatës në Ministrinë e Arsimit për licencimin e këtij programi të trajnimit bazik për këtë fushë. Në ndërkohë, ne kemi pasur deri më tani tri grupe të trajnimit të cilat i kemi mbajtur në Prishtinë, Podujevë dhe Gjilan. Një grup trajnerësh të cilët janë ekspertët më të mirë të kësaj fushe në Kosovë, do të vazhdojnë që të mbajnë këtë trajnim 32 orësh për mësimdhënësit edhe në komunat tjera të Kosovës.



Arsimi sot:

Çfarë mund të përfitojnë mësimdhënësit me këtë trajnim?

Albani:

Trajnimi “Edukimi Medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik”, është trajnim i licencuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, me një fond prej tridhjetë e dy orëve të cilat llogariten si orë të trajnimeve bazike që u kërkohen në vazhdimësi mësimdhënësve për avancimin e tyre. Përveç kësaj, mësimdhënësit fitojnë njohuri në përdorimin e medieve, dekonstruktimin e mesazhit që merret prej medieve, dhe këto njohuri mund t’i shfaqin duke e propozuar këtë lëndë të rëndësishme si lëndë zgjedhore për nxënësit e tyre. Përmbajtja e këtij trajnimi është e koncentruar në problemet kryesore që trajton Edukimi për Media duke u dhënë mësimdhënësve shkathtësitë e nevojshme për këtë fushë. Bazohet në një literaturë moderne dhe ligjërohet nga ekspertët më të mirë të kësaj fushe në Kosovë. Prandaj, mendoj që mësimdhënësit do të përfitonin shumë nëse e mbajnë këtë trajnim.



Arsimimi sot:

Si ndikon kjo punë në shoqëri?

Albani:

Edukimi për Media në shumicën e vendeve demokratike është lëndë obligative me qëllim që t’i mësojë të rinjtë që t’i dekodojnë mesazhet që marrin nga media, duke u nisur nga reklamat e deri te lajmet të cilat i shohin. Vendet e Bashkimit Evropian këtë lëndë e kanë futur si pjesë të planprogrameve të tyre që nga viti 2013, kur në BE është miratuar një rekomandim që thotë se të gjitha vendet anëtare dhe ato që synojnë integrimin duhet të përfshijnë Edukimin për Media në sistemin e tyre arsimor parauniversitar. Prandaj, duke u nisur nga këto fakte mund të konstatojmë që Edukimi për Media është një domosdoshmëri e kohës. Së pari, të rinjtë që do ta mësojnë këtë lëndë do të jenë shumë të përgatitur me njohuri dhe shkathtësi se si të sillen me përmbajtjen mediale dhe si t’i përdorin ato informacione në dobi të përgjithshme shoqërore.

Gjatë muajit

Në Tajlandë është mbajtur Kongresi i 8-të Botëror i Internacionales së Arsimit

Ngjarje e madhe me vendime të rëndësishme për arsimin kudo në botë

Komisionet e emëruara nga Internacionalja Botërore e Arsimit për përgatitjen e Kongresit 8 zgjedhor kishin nisur me kohë përgatitjet dhe vazhdimisht kanë komunikuar me sindikatat anëtare për të marrë ide e për të parë nga afër tekstet e Rezolutave të shumta që do të paraqiteshin në Kongres. Kontribut në gjithë këto angazhime ka dhënë edhe SBASHK-u duke dhënë mendime e duke dërguar amendamente për disa nga Rezolutat e parapara.





Gjithë ky përkushtim i komisioneve dhe i sindikatave anëtare ka bërë që ngjarja më e madhe e arsimit të botës të jetë përgatitur shumë mirë. Delegacionet nga e tërë bota kanë bërë rrugë të gjatë për të arritur në Bangkok të Tajlandës, por lodhja është harruar me të arritur në kryeqytetin e këtij shteti të largët ngase filluan takimet mes delegacioneve dhe në bashkëbiseda mes tyre flitej për gjendjen në arsimin e shteteve nga vinin ata.



Edhe delegacioni i SBASHK-ut, të cilin e përbënin kryetari Rrahman Jasharaj, nënkryetarja Vjollca Shala dhe menaxheri për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri me të arritur në Bangkok kanë nisur të zhvillonin takime me shumë nga sindikatat e arsimit nga Ballkani, Evropa dhe nga e tërë bota. Bisedat ishin spontane dhe në to flitej për sfidat, gjendjen momentale në arsim, por edhe për arritjet e shënuara nga këto sindikata mes dy Kongreseve. Të gjithë pajtoheshin se mbështetja dhe përkrahja morale që sindikatat i japin njëra-tjetrës në momente sfidash dhe në kohë grevash e protestash ka domethënie të madhe dhe kjo ka dëshmuar solidaritetin mes sindikatave që është virtut i lartë dhe domethënës. Delegacioni i SBASHK-ut duke u bërë pjesë e aktiviteteve të shumta para Kongresit ka marrë pjesë në tryeza tematike duke dhënë kontribut në temat që po trajtoheshin.



E diela në orën 17, sipas kohës lokale, ka shënuar edhe fillimin solemn të kësaj ngjarje të madhe. Në hapjen solemne rinia e Tajlandës ka shpalosur një program artistik duke prezantuar muzikën dhe veshjen kombëtare.

Pas kësaj kryetarja e Internacionales Botërore e Arsimit, znj. Susan Hopgood u është drejtuar sindikalistëve të arsimit nga e tërë bota me një fjalë rasti duke i kujtuar me sfidat nëpër të cilat po kalon arsimit kudo në botë, ku mes të tjerash ajo tha: "...A jeni gati për të marrë rol udhëheqës? Roli udhëheqës do të thotë avancim i profesionit tonë, promovimin e demokracisë, të drejtat e njeriut dhe të sindikatave dhe arsimim publik falas për të gjithë! Ajo gjithashtu ka kujtuar se ky sektor i rëndësishëm kudo po has në sfida e vështirësi, prandaj kërkohet përkushtim e unitet.

Një prezantim shumë përmbajtjesor ishte edhe paraqitja para delegatëve e sekretarit të përgjithshëm të Internacionales Botërore të Arsimit, David Edvards. Ai ka shpalosur aktivitetet e EI-së gjatë 4 viteve mes dy Kongreseve duke kujtuar se kishte dhe vazhdon të ketë shumë sfida e probleme në arsim që kërkojnë zgjidhje të shpejtë.

Fjala e sekretarit të përgjithshëm është përcjellë me duartrokitje të vazhdueshme duke shprehur kështu delegatët respektin për angazhimet e z. Edvards dhe duke treguar kështu unitetin dhe gatishmërinë për punë e angazhime të përbashkëta të sindikalistëve nga

e tërë bota edhe në të ardhmen në mënyrë që bashkërisht e duke shprehur solidaritet të tejkalojnë më lehtë sfidat e shumta.

Gjatë punimeve të Kongresit janë prezantuar Rezolutat dhe pas debatit për to pjesa më e madhe e tyre është votuar nga delegatët.

Një moment i veçantë i Kongresit ishte edhe zgjedhja e kryetarit, sekretarit të përgjithshëm dhe stafit tjetër udhëheqës.



Delegatët me votën e tyre i kanë dhënë besimin edhe për një mandat kryetares së EI-së, Susan Hopgood dhe sekretarit të përgjithshëm, David Edvards. Ata po ashtu kanë zgjedhur edhe nënkryetarët përfaqësues nga të gjitha kontinentet. Nënkryetare e EI-së nga Evropa është zgjedhur znj. Marlis Tepe, kryetare e sindikatës së arsimit gjerman (GEW).



Takime të veçanta të delegacionit të SBASHK-ut gjatë Kongresit 8

Respekt për angazhimet dhe arritjet, vendosshmëri për mbështetje



Delegacioni i SBASHK-ut gjatë ditëve të Kongresit zgjedhor të Internacionales Botërore të Arsimit në Bankok është takuar me shumë delegacione të sindikatave nga e tërë bota dhe me përfaqësuesit më të lartë të Internacionales Botërore të Arsimit dhe të Unionit të Sindikatave të arsimit të Evropës.

Një takim i veçantë ishte me kryetaren e Internacionales Botërore të Arsimit, znj. Susan Hopgood, me të cilën delegacioni i SBASHK-ut ka biseduar për aktualitetin në arsim dhe sfidat që po përballen arsimi në Kosovë.

Delegacioni i SBASHK-ut kishte një takim të veçantë edhe me mikun madh të arsimit të Kosovës, ish sekretarin e përgjithshëm të Ei-së, Fred Van Liven, i

cili në vitet e okupimit të Kosovës ishte kthyer në një zë të fuqishëm kudo në takimet nëpër botë për Kosovën dhe arsimin tonë, që po bënte qëndresë sublime në ruajtjen e dritës kundër errësirës. Ky mik i vjetër me kënaqësi ka folur për arritjet e SBASHK-ut dhe ka shprehur interesim për aktualitetin e arsimit në Kosovë. Edhe sekretari i tanishëm i Internacionales Botërore të Arsimit, David Edvards është takuar me delegacionin e SBASHK-ut dhe ka përsëritur se do të përkrah vazhdimisht angazhimet e SBASHK-ut në përpjekjet për të realizuar gjithë kërkesat legjitime të anëtarësisë.



Delegacioni i SBASHK-ut kishte një takim të veçantë edhe me drejtoreshen e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës(ETUCE), znj.Susan Flocken, në bashkëbisedë me përfaqësuesit e SBASHK-ut ajo i ka përgëzuar ata dhe punonjësit e arsimit në Kosovë për unitetin dhe qëndrimin dinjitoz në angazhimet për realizimin e kërkesave të arsyeshme. Delegacioni i

SBASHK-ut e ka njoftuar znj. Flocken për angazhimet dhe zhvillimet nga vizita e saj në Kosovë e deri sot. Ata po ashtu kanë treguar edhe për trajnimet e zhvilluara dhe shërbimet e angazhimet në shërbim të anëtarësisë, Drejtorja e ETUCE-së ka rikonfirmuar mbështetjen për SBASHK-un në të gjitha aktivitetet sindikale.

Reagim i SBASHK-ut lidhur me deklaratimet e Ministrit Bytyqi për Ligjin e viteve të 90-ta Punëtorët e arsimit dhe opinioni e di se kush dhe sa bëri për këtë Ligj

SBASHK



SINDIKATA E BASHKUAR E ARSIMIT, SHKENCËS DHE KULTURËS

Mediet dhe opinioni janë dëshmitarët më korrekt të përpjekjeve, përballjes me sfidat e madje edhe të

përplasjes së SBASHK-ut me përfaqësues institucionesh, me individ përgjegjës dhe me një pjesë të OJQ-ve, më përpjekjet 5 vjeçare për të pasur një Ligj meritore që vlerësuan angazhimet sublime të punëtorëve të arsimit shqip në mbrojtje të arsimit, kulturës e artit tonë nga përpjekjet rrënuese të pushtuesit.

SBASHK-u e ruajti kujtimin për mësuesin e viteve të 90-ta dhe pas shumë angazhimeve, takimeve me institucionet e deputetët arriti ta kthejë në vepër premtimin ndaj atyre që në vitet e 90-ta mbrojtën dritën kundër errësirës. Punëtorët e arsimit e dinë se kush dhe sa bëri për këtë Ligj. Ata u shprehin mirënjohje vazhdimisht udhëheqësve të SBASHK-ut duke e konsideruar si fitore të madhe e të përbashkët, Ligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta.

SBASHK-u nuk ka dashur të flas, e as të lavdërohet për gjithë përpjekjet e mëdha lidhur me Ligjin e viteve 90-ta, por duke parë se Ministri Bytyqi dhe individë aty këtu po tentojnë që këtë Ligj tepër domethënës ta kthejnë në merita e dekorata për vetën e tyre, SBASHK-u reagon duke kujtuar opinionin se ishte SBASHK-u, që me mund e sakrifica për 5 vite me

radhë arriti të ndikojë pozitivisht të përgjegjës që të punohet projektligji për vitet e 90-ta dhe që ai pastaj të kthehet në Ligj, Kjo u bë me mund e sakrifica. SBASHK-u do ta kujtoj me respekt angazhimin e cilit do nga përgjegjës institucional. Do ta kujtojë e do të shprehë respekt gjithmonë për Kryeministrin Haradinaj, i cili e tha në takimet me SBASHK-un dhe e kthen premtimin në realitet edhe pse kishte kundërshtime nga disa përfaqësues ndërkombëtar e disa përfaqësues vendor a OJQ-ia, nuk u zmbraps po e vuri në takimin e Qeverisë dhe Projektligji u votua për të vazhduar rrugëtimin drejt Parlamentit.

Mediet dhe opinioni e di se sa u stërgjatë debati publik mes dy leximeve, e di sa përplasjet kishin ndodhur, por përfaqësuesit e SBASHK-ut nuk u dorëzuan. Projektligji shkoi në leximin e dytë dhe faleminderit deputetëve që e votuan.

Ministri Bytyqi, që tani mundohet t'i vë vetit dekorata për Ligjin, gjatë gjithë kohës bëri fare pak, apo thënë saktë nuk bëri asgjë.

Sa u kujdes për mësuesin e viteve të 90-ta, Ministri Bytyqi e kanë parë mediet, punëtorët e arsimit dhe opinioni i gjerë. Ne po kujtojmë edhe një fakt, Ministri Bytyqi ka mundur tani e katër muaj ta nënshkruaj Udhëzimin Administrativ, që mundëson fillimin e aplikimeve të punëtorëve të viteve të 90-ta, që janë pensionuar. Ai nuk e bëri me kohë as këtë veprim, po e priti momentin e fundit.

E këshillojmë Ministrin Bytyqi dhe ca të tjerë të mos krenohen me frytet e punës së të tjerëve.

Opinionin e di se kush dhe sa po angazhohet.

Lidhur me idenë e MASHT për mësimin tërëditor

SBASHK- Në kushtet aktuale në arsimin tonë nuk ka mësim tërëditor

Në vend që të analizohet gjendja me tekstet shkollore. Në vend që të bëhet edhe një analizë shkencore e kurikulit. Në vend që të bëhet një analizë dhe të përgatitet një strategji për të përmirësuar kushtet në shkollat tona e për të pajisur ato me mjete të duhura të punës, MASHT vazhdon të dal me ide, që janë të parealizuara. Një nga to është edhe pilot prova për mësimin tërëditor. MASHT është deklaruar se do të provojnë me mësimin tërëditor me nga një shkollë në të gjitha komunat e Kosovës.



SBASHK-u ka kohë që ka bërë publik kundërshtimin ndaj këtij eksperimenti të radhës dhe e ka kundërshtuar idenë për mësimin tërëditor duke ofruar plot argumente. Edhe tani e tutje qëndrimi i SBASHK-ut është kundër mësimin tërëditor në kushtet aktuale në të cilat gjenden institucionet arsimore të Kosovës dhe duke u bazuar edhe në përvojat e shteteve tjera.

SBASHK-u kujton se në vendet e Evropës mësimi tërëditor nuk është obligativ dhe se organizohet më shumë për të ndihmuar fëmijët e ardhur në ato shtete dhe për të ndihmuar të tjetër që të nxisin talentin e tyre në lëmi të caktuara. Po ashtu SBASHK-u i ka bërë me dije edhe në takime në MASHT se me punëtorët aktual arsimor nuk mund të planifikohet mësimi tërëditor sepse ata e kanë të saktësuar numrin e orëve në Kontratën Kolektive të Arsimit, që do të thotë 20 orë punë në klasë me nxënësit, 15 orë përgatitje dhe 5 orë komunikim me nxënësit e me prindërit. Kjo është norma 40 orëshe e obliguar dhe atë normë mësimdhënësit e Kosovës e plotësojnë. MASHT-i para se të nis me mësimin tërëditor duhet fillimisht të rekrutojë kuadro të reja dhe po ashtu duhet të ndërtojë e sigurojë kuzhina shkollore me ushqime cilësore si kudo në Evropë e jo të planifikojë ushqim me kiflet e me qumësht. MASHT duhet të ndërtojë edhe objekte përcjellëse, qoftë salla sporti, qoftë ambiente në formë të teatrove dhe atyre për talentet e muzikës e të artit dhe pastaj të nis me mësimin tërëditor pasi të ketë krijuar këto kushte dhe pasi të ketë rekrutuar kuadro shtesë e të nevojshme për realizimin e një mësimi të tillë. Deri atëherë mësimi tërëditor nuk do të ketë.

Përshtypje të paharruara nga pushimet e organizuara prej SBASHK-ut

Momente që nuk harrohen kurrë



Anëtarësia e SBASHK-ut edhe këtë vit mbeti shumë e

kënaqur me organizimin e SBASHK-ut për pushime në bregdetin shqiptar.

Duke e vlerësuar dhe çmuar shumë kontributin e punëtorëve të arsimit në edukimin dhe arsimimin e brezave, SBASHK-u ka disa vite që i nderon ata me një aktivitet atraktiv, sa të këndshëm aq të nevojshëm për një pjesë bukur të madhe të anëtareve duke i dërguar ata në bregdetin shqiptar.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Anëtarësia e SBASHK-ut, nga të gjitha komunat e Kosovës të cilës janë përzgjedhur nga shkollat e tyre, kanë kaluar qaste të bukura buzë valëve te bregdetit shqiptar. Komisioni si dhe koordinatorët ishin ata që me shume vullnet janë përkujdesur që pushuesit të kenë momente të bukura të cilët ata i kanë lenë edhe ne fletorët e përshtypjeve.



Ata falënderojnë SBASHK-un për këtë aktivitet të qëlluar.

Gjatë kësaj kohe edhe kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj i ka vizituar pushuesit ne bregdetin shqiptar ku ka bashkëbiseduar me ta, si dhe ka parë atmosferen nga afer po ashtu ai i ka përgëzuar ata për kulturën e lartë dhe pastaj ka folë për aktualitetin në arsim dhe për sfidat dhe angazhimet e SBASHK-ut.

Kujtojmë se Kompleksi hotelier "Bonita" ishte një përzgjedhje e SBASHK-ut në bazë të ofertave, i cili ka ofruar shërbime shumë të mira dhe çmim të volitshëm, kështu që ka plotësuar atë që ka ofruar me kushte të shkëlqyeshme, për këtë ne nuk do të flasim sepse flasin vet përshtypjet e pushuesve prej të cilave ne i kemi shkëput vetem disa prej tyre të cilat i kemi me shkrim ku do i ndajmë me ju në vazhdim:

“ Ndjenjë e përvojë e re dhe shumë e bukur, ta përfaqësosh shkollën më udhëtimin gjashtë ditor në Durrës – Shqipëri, organizuar nga SBASHK-u. Ishim të kënaqura me kushtet që afruan hoteli “Bonita”, gjithçka ishte në nivelin e duhur”.

Me shumë respect:

Prof, Besa Bula dhe

Prof, Luljeta Sulhasi.

“ Falenderojm SBASHK-un që na mundësoi ta vizitojmë bukurin e bregdetit të Durrsit. Përshtypjet e mia janë shumë të mira për këtë pushim, çdo gjë ishte

në rregull duke filluar nga rrugëtimi, akomodimi, ushqimi dhe të gjitha gjërat që nevojiten për një pushim komd”.

Me respekt,

Driton Gashi.



Falenderojmë SBASHK-un që na mundëson
ta vizitojmë kulturën e brendshme të
Durrësit.

Përshkrimet e mia janë shumë të mira
për këtë pushim, që gjë ishte më
megjllë duke filluar nga organizimi, akomodimi
ushqimi dhe të gjitha gjërat që nevojiten
për një pushim komod.

Unë e ndjej veten të privilegjuar që
pata mundësinë të shijoj këtë pushim
të cilin nuk do ta kishim kurrë.
Me këtë rast e falenderoj udhëheqësin
e grupit Manigama Brtyqi e ata
u angazhuan shumë që ne të kishim
sa më mirë.

Me respekt
Dritan Gashi
Dritan Gashi

Date: 4.07.2019

Një organizim pushimi për punonjësit
e arsimit nga ana e SBASHK-ut shumë
i qëlluar dhe i tëpër i nevojshëm për
punonjësit e arsimit, respektivisht këto vitet
kë përfaqësojnë ishite njëqoft e qëlluar.
Pjesë dhe vitet e ardhshme do të
vazhdojë me këtë trend.

Mundësimi në objektet hoteliere njëqoft
komod për arsyë tërëse.

Uroj që SBASHK-u me njësit e reja
këtë lloj të pushimit të vazhdojë dhe
të kësht mundësi që të gjitha punonjësit
e arsimit të i shpërblejë me këtë lloj
pushimi.

me 4-07-2019
Golem

Pushuesi
Klavit Blaqi
sh. m. t. M. Ersteri
Gomolles - Istog

Grupi i femrave nga Ferizaji

Me grupi i mësimdhënësve e falenderojmë
SBASHK-un që na e ofroi mundësinë për të
kaluar këtë pesë ditë në pushim ^{sepse} na u

ofrua mundësia që të shkonim përvoja
me njërit-tjetrit. Ja u përketë kushteve
në hotel Bonita ishin jo edhe aq të
mira. Mendojmë se u nevojtes një mëjllë
më e mirë në shpërndarjen e ushqimit
(përvoja në radhë ishte shumë e lodhshme)
Vërejtje: Të përshkruhet më shumë pjesëmarrja
e femrave.

Megjithatë kaluar shumë mirë, shpërndarja
tëje bërë të vazhdojë pasi që mendojmë
që këto mjete janë kontributiv një.
02.07.2019

Përshkrimet e onizës

Unë Ajtet Ajeti si pushues
nga Sindikata e Bashkuar e
Arsimit në Durrës kam kaluar
shumë mirë duke filluar prej
mijës nga përdorjet autobusit
ka qenë shumë i mirë ka ardh
me këto mirë kemi kaluar rrugë
akomodimi në Hotel Bonita ka
qenë shumë i mirë, dhomat kanë
qenë shumë të mira, edhe ushqimi
ka qenë shumë i mirë, Aktivi tërë
i ditës në shtunë ka qenë shumë
i mirë dhe na ka relaksuar
ansambli Rugova, jemi takuar
me shumë koleg, kemi shkonë
shëndime.

Pra me një fjalë qendër
ka qenë një nivel të lartë
Ajtet Ajeti shumë kongresi i Manastirit
Hammit, K. Përdorjet,